

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT**



PUNIMI I DIPLOMËS – MASTER

Tema: DALLIMI I STILIT TË JETESËS TE FËMIJËT E MOSHËS 11-14 VJEÇAR NË ZONAT URBANE DHE RURALE NË KOMUNËN E PRISHTINËS

DIFFERNCE IN LIFESTYLE OF CHILDREN AGED 11-14 IN URBAN AND RURAL AREAS OF THE PRISTINA MUNICIPALITY

MENTORI:

Prof. As. Shqipe Bajqinca

KANDIDATI:

Bach. Arta Osmani

Prishtinë, Tetor 2018

PËRMBAJTJA

1. HYRJE.....	3
2. PROBLEMI, LËNDA, DHE QËLLIMI	6
3. HIPOTEZAT THEMELORE	7
4. METODAT E PUNËS	8
4.1 Rrjedha dhe procedura e hulumtimit.....	8
4.2 Mostra e të testuarve.....	9
4.3 Instrumentet matse të mostrës.....	9
4.4 Përpunimi statistikor i të dhënave.....	13
5. REZULTATET E HULUMTIMIT	13
6. RËNDEsia E HULUMTIMIT.....	32
7. DISKUTIM	33
8. PËRFUNDIM.....	37
9. LITERATURA.....	42

1. HYRJE

Një nga faktorët më të rëndësishëm për një gjendje më të mirë shëndetsore që nga fëmijëria e hershme e deri në pleqëri pa dyshim se është aktiviteti fizik i vazhdueshëm. Kemi prova të mjaftueshme që tregojnë se në dekadën e fundit fëmijet janë më pak aktiv sesa moshatarët e tyre shumë vite më parë.

Kushtet bashkëkohore të jetesës dhe të punës mund të konsiderohen të ndryshme nga ato të disa dekadave më parë. Zhvillimi i teknologjisë, shkencave kompjuterike, transportit dhe komunikimit ka përsheptuar jetën tonë të përditshme. Gjithashtu bota në të cilën fëmijët tonë po rriten ka ndryshuar. Rrjedhimisht, ritmi i rritur i jetesës i cili karakterizon jetën bashkëkohore ju ka siguruar njerëzve më shumë kohë të lirë, megjithatë më pak e përdorur për nevoja personale (Andrijašević, 2000).

Në vitet e fundit disa organizata ndërkombëtare si *American College of Sports Medicine* (ACSM) kanë rekomanduar që fëmijët duhet të marrin pjesë në aktivitete fizike > 60 min çdo ditë në mënyrë të organizuar si brenda dhe jashtë shkollës. Sot raporti i kohës në shkollë dhe koha e lirë po ndryshon gjithnjë e më shumë për fëmijët dhe të rinjtë. Fëmijët janë të mbingarkuar me detyrime të gjëra akademike dhe për këtë arsye është edhe më e rëndësishme të ju ofrohen atyre aktivitete të lira fizike në pjesën tjetër të ditës. Në kohën e lirë të fëmijëve rëndësi të madhe duhet ti kushtohet aktiviteteve fizike, nevojës themelore njerëzore për lëvizje dhe mirëmbajtje të jetës.

Dy orë në javë të Edukimit Fizik në arsimin fillor nuk janë të mjaftueshme, kështu që mësuesit vazhdimisht duhet të këshillojnë nxënësit që në kohën e tyre të lirë të merren sa më tepër me aktivitete fizike. Në një luftë të përditshme kundër pasivitetit dhe jetesës duke qëndruar i ulur, të rinjtë duhet të inkurajohen vazhdimisht për të ecur sa më shumë në këmbë, të angazhohen në lojëra sportive dhe një shumëllojshmëri të aktiviteteve të tjera sportive në veçanti ato në të cilat angazhohen në mënyrë aktive gjymtyrët, zemra dhe mushkëritë (Andrijašević, M., 2000).

Hulumtimet tregojnë se shumica e fëmijëve duan të jenë me miqtë e tyre gjatë kohës së lirë. Është e zakonshme të përdorin internetin, të shikojnë televizor dhe të dëgjojnë muzikë. Shumë angazhohen në aktivitete më të organizuara (The child's leisure time). Ndikimi i shoqërisë, prindërve, mësuesve dhe në veçanti mësuesit e Edukatës Fizike kanë një ndikim të madhë në përzgjedhjen e aktiviteteve të fëmijëve në kohën e tyre të lirë. (Badrić, M; Prskalo, I; Šilić, N.;, 2011) shkruan për dallimet strukturore në kohën e lirë në mesnxënësve në zonat urbane dhe rurale duke përdorur një mostër të fëmijëve nga klasa e pestë deri në të tetën. Rezultatet treguan se

fëmijët kanë shumë pak kohë të lirë. Ata kanë vetëm 23% të kohës që mbetet për aktivitetet e interesave dhe preferencave personale. Hulumtimet kanë treguar gjithashtu se fëmijët që jetojnë në zonat urbane shpenzojnë më shumë kohë të angazhuar në disa aktivitete fizike sesa ata që jetojnë në zonat rurale.

Të rinjtë në këtë moshë shpesh shkaktojnë probleme, janë të vështirë për të komunikuar, mund të ndodhë edhe fenomeni i "rebelimit rinor". Gjatë kësaj periudhe mund të shihni gjithashtu se aktiviteti fizik në kohën e lirë në një masë të madhe do të nvarret nga një numër aktivitete të cilat shkojnë përtej problemeve të ekipit që mbulohen nga kurrikula e shkollës por që merren me mjedisin arsimor në të cilin çdo nxënës rritet. Zhvillimi i interesave zhvillohet në lagje, klube dhe qarqe të ndryshme. Nga këndvështrimi i nevojave shëndetësore, pjesa më e rëndësishme e këtij aktiviteti duhet të bazohet në aktivitete fizike. Dihet që aktivitetet e tilla kanë një ndikim shumë pozitiv në zhvillimin e karakteristikave biologjike (stimulojnë rritjen, forcojnë trupin, zhvillojnë shpejtësinë, qëndrueshmërinë, përqëndrimin, përmirësojnë refleksin) (Umiastowska, 1999), dhe problemet psiko-sociale (vetëbesim, aftësinë për vetëkontroll, aftësinë për të punuar me njerëz të tjerë).

Për hir të qartësisë së pari termi i kohës së lirë kërkon sqarime. Për herë të parë u përcaktua gjatë një konference ndërkombëtare të mbajtur në vitin 1956. Siç përcaktohet nga sociologu francez (Dumazedier J, 1956), koha e lirë nënkupton të gjitha aktivitetet e marra nga një individ për argëtim ose vetë-zhvillim, pjesëmarrje vullnetare në jetën shoqërore jashtë sociale dhe përgjegjësitë familjare. Ky përkufizim i konsideron vetëm të rriturit. Nga ana tjetër, sipas (Dąbrowski, 1966), koha e lirë e të rinjve është koha, e cila mbetet në dispozicion të tyre pas përbushjes së nevojave të trupit të tyre dhe kryerjes së detyrave në shtëpi dhe në shkollë në të cilën ata mund të kryejnë aktivitetet e tyre në përputhje me shijet e tyre të lidhura me kohën e lirë, argëtimin dhe kënaqjen e interesave të tyre. Sipas autorve (Glapa, Bronikowski, Górka, & Morina, 2013), niveli i pasurisë (jo shumë i familjes, por i të gjithë vendit) mund të ketë ndikim në zgjedhjen e aktiviteteve të ndërmarra nga të rinjtë. Padyshim që faktorët socio-kulturorë dhe tradita e jetës shoqërore, të cilat imponojnë mënyra të caktuara të shpenzimit të kohës së lirë. Sipas (Rosić, 2005), koha e lirë e nxënësve ka disa dimensione pedagogjike: (1) është një formë e aktiviteteve të nxënësve me një objektiv të qartë; (2) ajo përfshin forma të ndryshme të aktivitetit; (3) bazohet në mundësitë e mjedisit natyror dhe social; (4) ajo mund të organizohet sipas interesave individuale, grupore dhe kolektive të studentëve; (5) të gjitha përmbajtjet, format, mjetet dhe metodat e përdorura duhet të kontribuojnë në formatimin dhe zhvillimin e një personaliteti të shëndetshëm. Më tej, (Šimunović, D; Njegovan-Zvonarević, T, 2008), thekson

disa klasifikime të kohës së lirë: (1) aktivitete që shërbejnë si pushim i zakonshëm; (2) rekreacion me pushim aktiv, rekreacion të shëndetshëm dhe argëtim si objektiva kryesore; dhe (3) aktivitete të dizajnuara për të zhvilluar personalitetin.

Për të marrë një pamje më të plotë të sjelljes së të rinjve në periudhën kritike sociale, psikologjike dhe fizike të rritjes, studimi kërkimor do të kryhet në dy zona, zonat urbane dhe rurale në Komunën e Prishtinës.

2. PROBLEMI, LËNDA DHE QËLLIMI

Problemi ihulumtimit është të hetojë situatën e gjendjes së aktiviteteve të lira të nxënësve në Shkollat fillore në zonat urbane dhe rurale në Komunën e Prishtinës.

Lënda, lëndae hulumtimit janë nxënësit e ciklit të tretë të shkollës fillore (klasat 6,7,8,9) femra në zonat urbane dhe rurale.

Në përputhje me objektin dhe problemin e definuar të këtij hulumtimi është përcaktuar edhe qëllimi kryesor i hulumtimit.

Qëllimi kryesor, qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është për të përcaktuar stilin e jetesës së fëmijëve, si dhe të shiqojm dallimet në mes të fëmijëve në zonat urbane dhe rurale.

3. HIPOTEZAT THEMELORE

Në bazë të lëndës, problemit të hulumtimit dhe qëllimit të hulumtimit, por edhe në përvojën e hulumtimeve të mëparshme, janë formuluar hipotezat e mëposhtme:

H₀: Nuk ka ndonjë dallim të rëndësishëm statistikor të aktiviteteve të lira të fëmijëve në zonat urbane dhe rurale.

A: Ka një dallim të rëndësishëm statistikor të aktiviteteve të lira të fëmijëve në zonat urbane dhe rurale.

4. METODAT E PUNËS

Të dhënat janë mbledhur përmes një pytsori. Një mjet hulumtues i përdorur për të vlerësuar mënyrën e jetesës së nxënësve, pytsor i quajtur "Stili im i jetesës", i hartuar nga një ekip hulumtuesish evropianë [Telama R., Naul R., Nupponen H., Rychtecky A., Vuolle P., 2002]. Pytsori është përkthyer dhe përshtatur nga një ekip profesional përkthyesish në bashkupunim me Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit, Prishtinë. Hulumtimi do të kryhet në grupin prej 200 fëmijëve- femra të moshës 11-14 vjeçare, nga të cilët 100 nxënës do të jenë nga zonat urbane, ndersa 100 nxënës do të jenë nga zona rurale.

Materiali hulumtues do të mblidhet gjatë muajit qershor të vitit 2018.

4.1 Rrjedha dhe procedura e hulumtimit

Mostra e studimit është marrur nga nxënësit e ciklit të tretë (Kurikula e Kosovës) të shkollës fillore femra nga zonat urbane dhe rurale nga Komuna e Prishtinës.

Drejtimin dhe procedura studimi do të përbëhet nga disa faza që përfshin:

Projektimin

Identifikimi i mostrës për testim

Realizimi i testimit dhe mbledhjes së të dhënave

Futja e rezultateve në kompjuter

Përpunimi i rezultateve

Interpretimi i rezultateve

Si dhe mbrojtja e temës

Testimi do të bëhet gjatë kohës sa nxënësit do të jenë në shkollë pra gjatë proqesit mësimor.

Për vlerësimin se qfarë bëjnë nxënësit në kohën e tyre të lirë kemi përzgjedhur një pytsor standart i quajtur "Stili im i jetesës", pytsor i cili është përdorur nga shumica e vendeve evropiane, i cili është i vlefshëm dhe unikë.

Të gjitha testet janë bërë në kushte të njëjta ose të ngjashme për çdo grup moshë të testuar.

Testuesit do të jenë mësues të edukimit fizik të cilët janë të arsimuar dhe trajnuar se si të plotësohet testi.

4.2 Mostra e të testuarve

Ky hulumtim është kryer me mostra të marra në shkolla fillore nxënës-femra nga zonat urbane dhe rurale, të moshës (11-14) vjet. Numri i përgjithshëm ka qenë 200 nxënës të anketuar, 100 vajza nga zonat urbane dhe 100 vajza nga zonat rurale.

Në mostërkemi prfshirë nxënës nga shkolla të ndryshme që përfshinë Komunën e Prishtinës, përzgjedhja e nxënësve është bërë mbi bazën e një kampioni të thjesht të rastit, ku ata janë testuar në mënyrë vullnetare.

4.3 Instrumentet matse të mostrës

Për vlersimin e gjendjes se qfarë bejnë nxënsit me tepër në kohën e tyre të lirë do të përdorim një pytsor të quajtur “ Stili im i jetesës” i cili në vete përmban tetë pyetje:

PYETËSORI : STILI IM I JETESËS”

1. Si e kaloni kohën tuaj të lirë? (Ju mund të zgjidhni tri përgjigjëje)

- a) Ndëgjoj muzik
- b) Luaj muzik në instrumente, këndoj në korë, në grup
- c) Shikoj TV. video
- d) Takoj shokët
- e) Luaj letra ose lojra bordit
- f) Luaj lojra të kompjuterit
- g) Lexoj libra, gazeta
- h) Praktikoj sport në klub, në një seksion të sportit
- i) Praktikoj sport me miqt në fushën e sportit

- j) Shkoj në gara si spektator
- k) Shkoj në disko
- l) Shkoj në kinema, teater, koncert
- m) hobi (psh: fotografia, modelizmi, mbledhja e sendeve etj)
- n) Cfarë lloj hobi keni? _____
- o) Vizita në familje (gjyshen, gjyshin, axhen, hallen)
- p) Nuk bejë asgjë (shtrihem në shtrat, ënderroj, flej gjatë ditës)
- q) Luaj me shokë
- r) Nëse aktivitete të ndryshme ju lutem shënoni cfarë lloji?

1. Sa herë gjatë tre muajve të fundit, keni ndermarrë aktivitet fizik në kohën tuaj të lirë (se paku 30 minuta)

- a) asnjëherë
- b) me pak se një herë në javë
- c) një herë në javë
- d) dy herë në javë
- e) tre herë në javë
- f) pesë herë në javë
- g) cdo ditë

1. Cilat forma të aktivitetit fizik ju i ndërmerri gjatë kohës suaj të lirë?

No	Forma	Nganjher	Asnjëher	Shpesh
	Vrapimi			
	Noti			
	Vozis bicikletën			
	Roller-skating (patinazh)			
	Basketboll			
	Volejboll			
	Futboll			
	Hendboll			
	Aerobik			
	Ngritje peshe (body building)			

	Skate boarding			
	Patinazh			
	Skijim			
	Snowboard			
	Gjumnastik			
	Artet marciale (Aikido, karate)			
	Të tjera			

1. **Unë marrë pjesë në veprimtari të ndryshme fizike, sepse...** (shenoni maksimum tre arsye)

- a) Për karrier sportive
- b) Të takoj njerëz të rinjë
- c) Më pëlqejn garat
- d) Për gjendje të mirë fizike
- e) Për relaksim
- f) Për shëndet
- g) Të dukem mirë/bukur
- h) Për nota me të mira në EF
- i) Për të takuar miq
- j) Për argëtim
- k) Unë mund ti përmbush ambicjet e mia sportive
- l) Familja më inkurajon
- m) Për përfitime financiare

1. **Unë ndërmarr aktivitet fizik në kohën lirë me...**

- a) Me prindër
- b) Me motra dhe vëllezër
- c) Me shokë
- d) Vetë
- e) Me të tjerë...

1. **Mendoj që jamë.....**

- a) Shumë i shëndetshëm
- b) I shëndetshëm
- c) I sëmur
- d) Nuk mund të vleresoj shëndetin tim

1. E vleresoj fitnesin tim motorik si të...

- a) Jashtëzakonshëm
- b) Shumë i mirë
- c) Mirë
- d) Mjaftueshëm
- e) I keqë

1. Prinderit e juaj, a ndërmarrin ndonjë formë të sportit në kohën e tyre të lirë?

Nëna

- a) Nuk ndermerr
- b) Nganjëher ndërmerr
- c) Rregullisht ndermerr
- d) Nuk e di

Babai

- a) Nuk ndermerr
- b) Nganjëher ndërmerr
- c) Rregullisht ndërmerr
- d) Nuk e di

4.4 Përpunimi statistikor i të dhënave

Për përpunimin e të dhënave do të përdoret “Chi Square Test” që na lejon të dimë nëse dy grupe kanë mendime shumë të ndryshme, gjë që e bënë atë një statistikë shumë të dobishme për hulumtimin e anketave.

5. REZULTATET E HULUMTIMIT

Table 1. Si e kaloni kohën tuaj të lirë? (Ju mund të zgjidhni tri përgjigjeje)

	Urbane		Rurale		Chi-Square	Sig.
	Count	Percent	Count			
Dëgjoj muzikë	81	61.4%	51	38.6%	20.05	.000
Luaj muzikë në instrumente, këndoj në korë, në grup	3	42.9%	4	57.1%	.14	.700
Shikoj TV. video	42	56.0%	33	44.0%	1.72	.189
Takoj shokët	26	40.0%	39	60.0%	3.85	.050
Luaj letra ose lojëra bordit	1	50.0%	1	50.0%	.00	1.000
Luaj lojëra të kompjuterit	19	31.1%	42	68.9%	12.47	.000
Lexoj libra, gazeta	25	53.2%	22	46.8%	.25	.617
Praktikoj sport në klub, në një seksion të sportit	14	77.8%	4	22.2%	6.10	.013
Praktikoj sport me miqtë në fushën e sportit	16	80.0%	4	20.0%	8.00	.005
Shkoj në gara si spektator	4	25.0%	12	75.0%	4.34	.037
Shkoj në disko	3	60.0%	2	40.0%	.20	.651
Shkoj në kinema, teatër, koncert	5	71.4%	2	28.6%	1.33	.248
Hobi (psh: fotografia, modelimi, mbledhja e sendeve etj)	4	80.0%	1	20.0%	1.84	.174
Çfarë lloj hobi kenë?	8	88.9%	1	11.1%	5.70	.017
Vizita në familje (gjyshen, gjyshin, axhën, hallën)	20	35.7%	36	64.3%	6.34	.012
Nuk bëjë asgjë (shtrihem në shtrat, ëndërroj, flejë gjatë ditës)	11	68.8%	5	31.3%	2.44	.118
Luaj me shokë	19	32.8%	39	67.2%	9.71	.002

Tabela 1 tregon se si nxënësit e kalojnë kohën e tyre të lirë. Në këtë pyetje, nxënësit kanë pasur të drejtë që të përgjigjen në tri alternativa se si ata e kalojnë kohën e tyre të lirë. Në bazë të tabelës, rezultatet tregojnë se 81 nxënës në zonat urbane janë përgjigjur se dëgjojnë muzikë gjatë kohës së tyre të lirë, ndërsa 51 nxënës në zonat rurale janë përgjigjur se dëgjojnë muzikë gjatë kohës së tyre të lirë, sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolona 6-sigifikancë e raportuar në kolonen e fundit, për 5% nivel të signifikancës, është më e vogël se vlera $p - 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zonat urbane dhe rurale. 3 nxënës nga zonat urbane janë përgjigjur se luajn muzikë në instrumente, këndojn në korë, në grupë gjatë kohës së tyre të lirë, ndërsa 4 nxënës nga zonat rurale janë përgjigjur se luajn muzikë në instrumente, këndojn në korë, në grupë gjatë kohës së tyre të lirë, sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolona 6-sigifikancë e raportuar në kolonen e fundit, për 5% nivel të signifikancës është më e madhe se vlera $p - 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zonat urbane dhe rurale. 42 nxënës nga zonat urbane janë përgjigjur se shikojn televizionin gjatë kohës së tyre të lirë, ndërsa 33 nxënës nga zonat rurale janë përgjigjur se shikojn televizionin gjatë kohës së tyre të lirë, sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolona 6-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifikancës, është më e madhe se vlera $p - 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zonat urbane dhe rurale. 26 nxënës nga zonat urbane janë përgjigjur se takojnë shokët e tyre gjatë kohës së tyre të lirë, ndërsa 39 nxënës nga zonat rurale janë përgjigjur se takojnë shokët e tyre gjatë kohës së tyre të lirë, sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojn se në bazë të kolona 6-sigifikancë e raportuar në kolonen e fundit, për 5% nivel të signifikancës, është më e vogël se vlera $p - 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zonat urbane dhe rurale. 1 nxënës nga zonat urbane është përgjigjur se luan me letra gjatë kohës së tij të lirë, ndërsa po ashtu 1 nxënës nga zonat rurale është përgjigjur se luan me letra gjatë kohës së tij të lirë, sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojn se në bazë të kolona 6-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifikancës, është më e madhe se vlera $p - 0.05$, dhe

në këtë rast mund të themi se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zonat urbane dhe rurale. 19 nxënës nga zonat urbane janë përgjigjur se luajn lojëra të kompjuterit gjatë kohës së tyre të lirë, ndërsa 42 nxënës nga zonat rurale janë përgjigjur se luajn lojëra të kompjuterit gjatë kohës së tyre të lirë, sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolona 6-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifikancës, është më e vogël se vlera $p - 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zonat urbane dhe rurale. 25 nxënës nga zonat urbane janë përgjigjur se lexojnë libra, gazeta gjatë kohës së tyre të lirë, ndërsa 22 nxënës nga zonat rurale janë përgjigjur se lexojnë libra, gazeta gjatë kohës së tyre të lirë, sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolona 6-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifikancës, është më e madhe se vlera $p - 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zonat urbane dhe rurale. 14 nxënës nga zonat urbane janë përgjigjur se praktikojn sport në klube, në një seksion të sportit gjatë kohës së tyre të lirë, ndërsa 4 nxënës nga zonat rurale janë përgjigjur se praktikojn sport në klube, në një seksion të sportit gjatë kohës së tyre të lirë, sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolona 6-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifikancës, është më e vogël se vlera $p - 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zonat urbane dhe rurale. 16 nxënës nga zonat urbane janë përgjigjur se praktikojn sport me miqtë në fushën e sportit gjatë kohës së tyre të lirë, ndërsa 4 nxënës nga zonat rurale janë përgjigjur se praktikojn sport me miqtë në fushën e sportit gjatë kohës së tyre të lirë, sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolona 6-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifikancës, është më e vogël se vlera $p - 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zonat urbane dhe rurale. 4 nxënës nga zonat urbane janë përgjigjur se shkojnë në gara si spektator gjatë kohës së tyre të lirë, ndërsa 12 nxënës nga zonat rurale janë përgjigjur se shkojnë në gara si spektator gjatë kohës së tyre të lirë, sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolona 6-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifikancës, është më e vogël se vlera $p - 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga

zonat urbane dhe rurale. 3 nxënës nga zonat urbane janë përgjigjur se shkojnë në disko gjatë kohës së tyre të lirë, ndërsa 11 nxënës nga zonat rurale janë përgjigjur se shkojnë në disko gjatë kohës së tyre të lirë, sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolona 6-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifkancës, është më e madhe se vlera $p - 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zonat urbane dhe rurale. 5 nxënës nga zonat urbane janë përgjigjur se shkojnë në kinema, teatër, koncert gjatë kohës së tyre të lirë, ndërsa 2 nxënës nga zonat rurale janë përgjigjur se shkojnë në kinema, teatër, koncert gjatë kohës së tyre të lirë, sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolona 6-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifkancës, është më e madhe se vlera $p - 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zonat urbane dhe rurale. 4 nxënës nga zonat urbane janë përgjigjur se kanë hobi (psh: fotografia, modelimi, mbledhja e sendeve etj) gjatë kohës së tyre të lirë, ndërsa 1 nxënës nga zonat rurale është përgjigjur se ka hobi (psh: fotografia, modelimi, mbledhja e sendeve etj) gjatë kohës së tij të lirë, sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolona 6-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifkancës, është më e madhe se vlera $p - 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zonat urbane dhe rurale. 8 nxënës nga zonat urbane janë përgjigjur se bëjnë vizita në familje (gjyshen, gjyshin, axhën, hallën) gjatë kohës së tyre të lirë, ndërsa 1 nxënës nga zonat rurale është përgjigjur se bënë vizita në familje (gjyshen, gjyshin, axhën, hallën) gjatë kohës së tij të lirë, sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolona 6-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifkancës, është më e vogël se vlera $p - 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zonat urbane dhe rurale. 20 nxënës nga zonat urbane janë përgjigjur se nuk bëjnë asgjë (shtrihem në shtrat, ëndërroj, flejë gjatë ditës) gjatë kohës së tyre të lirë, ndërsa 36 nxënës nga zonat rurale janë përgjigjur se nuk bëjnë asgjë (shtrihem në shtrat, ëndërroj, flejë gjatë ditës) gjatë kohës së tyre të lirë, sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolona 6-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifkancës, është më e madhe se vlera $p - 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij

aktiviteti në mes të nxënësve nga zonat urbane dhe rurale. 11 nxënës nga zonat urbane janë përgjigjur se luajn me shokë gjatë kohës së tyre të lirë, ndërsa 5 nxënës nga zonat rurale janë përgjigjur se luajn me shokë gjatë kohës së tyre të lirë, sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolona 6-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifkancës, është më e madhe se vlera $p = 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zonat urbane dhe rurale.

Table 2. Sa herë gjatë tre muajve të fundit, keni ndërmarrë aktivitet fizik në kohën tuaj të lirë (së paku 30 minuta)

	Urbane		Rurale		Total
	Numërimi	Përqindja	Numërimi	Përqindja	Numërimi
Asnjëherë	7	50.0%	7	50.0%	14
Më pak se një herë në javë	7	29.2%	17	70.8%	24
Një herë në javë	16	45.7%	19	54.3%	35
Dy herë në javë	19	41.3%	27	58.7%	46
Tre herë në javë	23	54.8%	19	45.2%	42
Pesë herë në javë	12	66.7%	6	33.3%	18
Çdo ditë	16	76.2%	5	23.8%	21
Chi-Square = 13.958 Sig. .030					

Tabela 2 tregon se sa herë gjatë tre muajve të fundit, kanë ndërmarrë aktivitet fizik në kohën e tyre të lirë (së paku 30 minuta). Në këtë pyetje, nxënësit kanë pasur të drejtë që të përgjigjen në një alternativë se sa herë gjatë tre muajve të fundit, kanë ndërmarrë aktivitet fizik në kohën e tyre të lirë (së paku 30 minuta).

Në bazë të tabelës, rezultatet tregojnë se 7 nxënës nga zonat urbane janë përgjigjur se asnjëherë nuk ndërmarrin aktivitet fizik në kohën e tyre të lirë (së paku 30 minuta), ndërsa po ashtu 7 nxënës nga zonat rurale janë përgjigjur se nuk ndërmarrin aktivitet fizik në kohën e tyre të lirë (së paku 30 minuta). 7 nxënës nga zonat urbane janë përgjigjur se më pak se një herë në javë ndërmarrin aktivitet fizik në kohën e tyre të lirë (së paku 30 minuta), ndërsa 17 nxënës nga zonat rurale janë përgjigjur se më pak se një herë në javë ndërmarrin aktivitet fizik në kohën e tyre të lirë (së paku 30 minuta). 16 nxënës nga

zonaturbane janë përgjigjur se një herë në javë ndërmarrin aktivitet fizik në kohën e tyre të lirë (së paku 30 minuta), ndërsa 19 nxënës nga zonat rurale janë përgjigjur se një herë në javë ndërmarrin aktivitet fizik në kohën e tyre të lirë (së paku 30 minuta). 19 nxënës nga zonat urbane janë përgjigjur se dy herë në javë ndërmarrin aktivitet fizik në kohën e tyre të lirë (së paku 30 minuta), ndërsa 27 nxënës nga zonat rurale janë përgjigjur se dy herë në javë ndërmarrin aktivitet fizik në kohën e tyre të lirë (së paku 30 minuta). 23 nxënës nga zonat urbane janë përgjigjur se tri herë në javë ndërmarrin aktivitet fizik në kohën e tyre të lirë (së paku 30 minuta), ndërsa 19 nxënës nga zonat rurale janë përgjigjur se tri herë në javë ndërmarrin aktivitet fizik në kohën e tyre të lirë (së paku 30 minuta). 12 nxënës nga zonat urbane janë përgjigjur se pesë herë në javë ndërmarrin aktivitet fizik në kohën e tyre të lirë (së paku 30 minuta), ndërsa 6 nxënës nga zonat rurale janë përgjigjur se pesë herë në javë ndërmarrin aktivitet fizik në kohën e tyre të lirë (së paku 30 minuta). 16 nxënës nga zonat urbane janë përgjigjur se qdo ditë ndërmarrin aktivitet fizik në kohën e tyre të lirë (së paku 30 minuta), ndërsa 5 nxënës nga zonat rurale janë përgjigjur se qdo ditë ndërmarrin aktivitet fizik në kohën e tyre të lirë (së paku 30 minuta).

Sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të rreshtit të 8-sigifikancë e raportuar në rreshtin e fundit, për 5% nivel të signifkancës, është më e vogël se vlera $p - 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zonat urbane dhe rurale.

Table 3. Cilat forma të aktivitetit fizik ju i ndërmerrni gjatë kohës suaj të lirë?

Format e aktivitetit motorik	Nganjëherë			Asnjëherë			Shpesh		
	U	R	T	U	R	T	U	R	T
a) vrapim	52.3%	47.7%	109	13.3%	86.7%	30	63.9%	36.1%	61
b) noti	45.0%	55.0%	100	53.3%	46.7%	75	60.0%	40.0%	25
c) çiklizëm	57.9%	42.1%	76	47.7%	52.3%	44	43.8%	56.3%	80
d) roller-skating	66.7%	33.3%	30	46.2%	53.8%	158	58.3%	41.7%	12
e) basketboll	48.5%	51.5%	97	35.8%	64.2%	53	68.0%	32.0%	50
f) vollejboll	53.7%	46.3%	95	38.2%	61.8%	55	56.0%	44.0%	50
g) futball	47.8%	52.2%	67	54.8%	45.2%	104	37.9%	62.1%	29
h) handboll	36.1%	63.9%	61	60.2%	39.8%	123	25.0%	75.0%	16

i) aerobik	36.2%	63.8%	47	52.5%	47.5%	141	75.0%	25.0%	12
j) ngritje peshe	36.1%	63.9%	36	53.2%	46.8%	158	50.0%	50.0%	6
k)skateboarding	34.8%	65.2%	23	51.7%	48.3%	172	60.0%	40.0%	5
l) patinazh	47.7%	52.3%	44	50.6%	49.4%	156	0.0%	0.0%	0
m) skijim	67.6%	32.4%	74	37.0%	63.0%	119	85.7%	14.3%	7
n) snowboarding	40.0%	60.0%	25	50.3%	49.7%	169	83.3%	16.7%	6
p) gjimnastikë	71.2%	28.8%	73	32.7%	67.3%	110	70.6%	29.4%	17
q) Artet marciale (Aikido, karate)	51.5%	48.5%	33	48.1%	51.9%	160	85.7%	14.3%	7
r) tjera	64.8%	35.2%	54	36.9%	63.1%	122	83.3%	16.7%	24

U – Urban, R – Rural, T – Total

Tabela 3 tregon se cilat forma të aktivitetit fizik i ndërmarrin nxënësit gjatë kohës së tyre të lirë. Në këtë pyetje, nxënësit kanë pasur të drejtë që të përgjigjen në njërin nga alternativat e aktivitetit fizik, ku çdo alternativë ka pasur tri alternativaqë njërin nga to është dashur të zgjedhë: nganjëher, asnjëher dhe shpesh.

Në bazë të tabelës, rezultatet tregojnë se nga 109 përgjegjëje 52.3% e nxënësve nga zonat urbane dhe 47.7% e nxënësve nga zonat rurale në kohën e tyre të lirë nganjëher bëjnë vrapim, nga 30 përgjegjëje. 13.3% e nxënësve nga zonat urbane dhe 86.7% e nxënësve nga zonat rurale në kohën e tyre të lirë asnjëherë nuk bëjnë vrapim, si dhe nga 61 përgjegjëje 63.9% e nxënësve nga zonat urbane dhe 36.1% e nxënësve nga zonat rurale në kohën e tyre të lirë shpesh bëjnë vrapim. Nga 100 përgjegjëje 45.0% e nxënësve nga zonat urbane dhe 55.0% e nxënësve nga zonat rurale në kohën e tyre të lirë nganjëherë bëjnë not, nga 75 përgjegjëje 53.3% e nxënësve nga zonat urbane dhe 46.7% e nxënësve nga zonat rurale në kohën e tyre të lirë asnjëherë nuk bëjnë not, si dhe nga 25 përgjegjëje 60.0% e nxënësve nga zonat urbane dhe 40.0% e nxënësve nga zonat rurale në kohën e tyre të lirë shpesh bëjnë not. Nga 76 përgjegjëje 57.9% e nxënësve nga zonat urbane dhe 42.1% e nxënësve nga zonat rurale në kohën e tyre të lirë nganjëherë bëjnëçiklizëm, nga 44 përgjegjëje 47.7% e nxënësve nga zonat urbane dhe 52.3% e nxënësve nga zonat rurale në kohën e tyre të lirë asnjëherë nuk bëjnë çiklizëm, si dhe nga 80 përgjegjëje 43.8% e nxënësve nga zonat urbane dhe 56.3% e nxënësve nga zonat rurale në kohën e tyre të lirë shpesh bëjnëçiklizëm. Nga 30 përgjegjëje 66.7% e nxënësve nga zonat urbane

dhe 33.3% e nxënësve nga zonat rurale në kohën e tyre të lirë nganjëherë bëjnë roller-skating, nga 158 përgjegjëje 46.2% e nxënësve nga zonat urbane dhe 53.8% e nxënësve nga zonat rurale në kohën e tyre të lirë asnjëherë nuk bëjnë roller-skating, si dhe nga 12 përgjegjëje 58.3% e nxënësve nga zonat urbane dhe 41.7% e nxënësve nga zonat rurale në kohën e tyre të lirë shpesh bëjnë roller-skating. Nga 97 përgjegjëje 48.5% e nxënësve nga zonat urbane dhe 51.5% e nxënësve nga zonat rurale në kohën e tyre të lirë nganjëherë luajnë basketboll, nga 53 përgjegjëje 35.8% e nxënësve nga zonat urbane dhe 64.2% e nxënësve nga zonat rurale në kohën e tyre të lirë asnjëherë nuk luajnë basketboll, si dhe nga 50 përgjegjëje 68.0% e nxënësve nga zonat urbane dhe 32.0% e nxënësve nga zonat rurale në kohën e tyre të lirë shpesh luajnë basketboll. Nga 95 përgjegjëje 53.7% e nxënësve nga zonat urbane dhe 46.3% e nxënësve nga zonat rurale në kohën e tyre të lirë nganjëherë luajnë volejbol, nga 55 përgjegjëje 38.2% e nxënësve nga zonat urbane dhe 61.8% e nxënësve nga zonat rurale në kohën e tyre të lirë asnjëherë nuk luajnë volejbol, si dhe nga 50 përgjegjëje 56.0% e nxënësve nga zonat urbane dhe 44.0% e nxënësve nga zonat rurale në kohën e tyre të lirë shpesh luajnë volejbol. Nga 67 përgjegjëje 47.8% e nxënësve nga zonat urbane dhe 52.2% e nxënësve nga zonat rurale në kohën e tyre të lirë nganjëherë luajnë futboll, nga 104 përgjegjëje 54.8% e nxënësve nga zonat urbane dhe 45.2% e nxënësve nga zonat rurale në kohën e tyre të lirë asnjëherë nuk luajnë futboll, si dhe nga 29 përgjegjëje 37.9% e nxënësve nga zonat urbane dhe 62.1% e nxënësve nga zonat rurale në kohën e tyre të lirë shpesh luajnë futboll. Nga 61 përgjegjëje 36.1% e nxënësve nga zonat urbane dhe 39.8% e nxënësve nga zonat rurale në kohën e tyre të lirë nganjëherë luajnë hendboll, nga 298 përgjegjëje 46.0% e meshkujve dhe 63.9% e nxënësve nga zonat rurale në kohën e tyre të lirë asnjëherë nuk luajnë hendboll, si dhe nga 123 përgjegjëje 60.2% e nxënësve nga zonat urbane dhe 39.8% e nxënësve nga zonat rurale në kohën e tyre të lirë shpesh luajnë hendboll. Nga 47 përgjegjëje 36.2% e nxënësve nga zonat urbane dhe 63.8% e nxënësve nga zonat rurale në kohën e tyre të lirë nganjëherë bëjnë aerobi, nga 141 përgjegjëje 52.5% e nxënësve nga zonat urbane dhe 47.5% e nxënësve nga zonat rurale në kohën e tyre të lirë asnjëherë nuk bëjnë aerobi, si dhe nga 12 përgjegjëje 75.0% e nxënësve nga zonat urbane dhe 25.0% e nxënësve nga zonat rurale në kohën e tyre të lirë shpesh bëjnë aerobi. Nga 36 përgjegjëje 36.1% e nxënësve nga zonat urbane dhe 63.9% e nxënësve nga zonat rurale në kohën e tyre të lirë nganjëherë bëjnë ngritje peshe, nga 158 përgjegjëje 53.2% e nxënësve nga zonat urbane dhe 46.8% e nxënësve nga zonat rurale

në kohën e tyre të lirë asnjëherë nuk bëjnë ngritje peshe, si dhe nga 6 përgjegjëje 50.0% e nxënësve nga zonat urbane dhe 50.0% e nxënësve nga zonat rurale në kohën e tyre të lirë shpesh bëjnë ngritje peshe. Nga 23 përgjegjëje 34.8% e nxënësve nga zonat urbane dhe 65.2% e nxënësve nga zonat rurale në kohën e tyre të lirë nganjëherë bëjnë skateboarding, nga 172 përgjegjëje 51.7% e nxënësve nga zonat urbane dhe 48.3% e nxënësve nga zonat rurale në kohën e tyre të lirë asnjëherë nuk bëjnë skateboarding, si dhe nga 5 përgjegjëje 60.0% e nxënësve nga zonat urbane dhe 40.0% e nxënësve nga zonat rurale në kohën e tyre të lirë shpesh bëjnë skateboarding. Nga 44 përgjegjëje 47.7% e nxënësve nga zonat urbane dhe 52.3% e nxënësve nga zonat rurale në kohën e tyre të lirë nganjëherë bëjnë patinazh, nga 156 përgjegjëje 50.6% e nxënësve nga zonat urbane dhe 49.4% e nxënësve nga zonat rurale në kohën e tyre të lirë asnjëherë nuk bëjnë patinazh, si dhe 0 përgjegjëje nga nxënësit në zonat urbane dhe rurale kemi se shpesh bëjnë patinazh. Nga 74 përgjegjëje 67.6% e nxënësve nga zonat urbane dhe 32.4% e nxënësve nga zonat rurale në kohën e tyre të lirë nganjëherë bëjnë skijim, nga 119 përgjegjëje 37.0% e nxënësve nga zonat urbane dhe 63.0% e nxënësve nga zonat rurale në kohën e tyre të lirë asnjëherë nuk bëjnë skijim, si dhe nga 7 përgjegjëje 85.7% e nxënësve nga zonat urbane dhe 14.3% e nxënësve nga zonat rurale në kohën e tyre të lirë shpesh bëjnë skijim. Nga 25 përgjegjëje 40.0% e nxënësve nga zonat urbane dhe 60.0% e nxënësve nga zonat rurale në kohën e tyre të lirë nganjëherë bëjnë snowbording, nga 169 përgjegjëje 50.3% e nxënësve nga zonat urbane dhe 49.7% e nxënësve nga zonat rurale në kohën e tyre të lirë asnjëherë nuk bëjnë snowbording, si dhe nga 6 përgjegjëje 83.3% e nxënësve nga zonat urbane dhe 16.7% e nxënësve nga zonat rurale në kohën e tyre të lirë shpesh bëjnë snowbording. Nga 73 përgjegjëje 71.2% e nxënësve nga zonat urbane dhe 28.8% e nxënësve nga zonat rurale në kohën e tyre të lirë nganjëherë bëjnë gjimnastikë, nga 110 përgjegjëje 32.7% e nxënësve nga zonat urbane dhe 67.3% e nxënësve nga zonat rurale në kohën e tyre të lirë asnjëherë nuk bëjnë gjimnastikë, si dhe nga 17 përgjegjëje 70.6% e nxënësve nga zonat urbane dhe 29.4% e nxënësve nga zonat rurale në kohën e tyre të lirë shpesh bëjnë gjimnastikë. Nga 33 përgjegjëje 51.5% e nxënësve nga zonat urbane dhe 48.5% e nxënësve nga zonat rurale në kohën e tyre të lirë nganjëherë bëjnë artet marciale (aikido, karate), nga 160 përgjegjëje 48.1% e nxënësve nga zonat urbane dhe 51.9% e nxënësve nga zonat rurale në kohën e tyre të lirë asnjëherë nuk bëjnë artet marciale (aikido, karate), si dhe nga 7 përgjegjëje 85.7% e nxënësve nga zonat urbane

dhe 14.3% e nxënësve nga zonat rurale në kohën e tyre të lirë shpesh bëjnë artet marciale (aikido, karate). Nga 54 përgjegjëje 64.8% e nxënësve nga zonat urbane dhe 35.2% e nxënësve nga zonat rurale në kohën e tyre të lirë nganjëherë bëjnë të tjera aktivitete, nga 122 përgjegjëje 36.9% e nxënësve nga zonat urbane dhe 63.1% e nxënësve nga zonat rurale në kohën e tyre të lirë asnjëherë nuk bëjnë të tjera aktivitete, si dhe nga 24 përgjegjëje 83.3% e nxënësve nga zonat urbane dhe 16.7% e nxënësve nga zonat rurale në kohën e tyre të lirë shpesh bëjnë të tjera aktivitete.

Table 4. Unë marrë pjesë në veprimtari të ndryshme fizike, sepse... (shënoni maksimum tre arsye)

	Urbane		Rurale		Total	Chi-Square	Sig.
	Count	Percent	Count	Percent			
Për karrierë sportive	34	70.8%	14	29.2%	48	10.96	.00
Të takoj njerëz të rinj	6	35.3%	11	64.7%	17	1.60	.20
Më pëlqejnë garat	29	45.3%	35	54.7%	64	.82	.36
Për gjendje të mirë fizike	34	50.0%	34	50.0%	68	.00	1.00
Për relaksim	46	49.5%	47	50.5%	93	.02	.88
Për shëndet	67	51.5%	63	48.5%	130	.35	.55
Të duket mirë/bukur	8	40.0%	12	60.0%	20	.88	.34
Për nota më të mira në EF	6	30.0%	14	70.0%	20	3.55	.05
Për të takuar miq	8	38.1%	13	61.9%	21	1.33	.24
Për argëtim	48	50.0%	48	50.0%	96	.00	1.00
Unë mund ti përmbush ambiciet e mia sportive	8	50.0%	8	50.0%	16	.00	1.00
Familja më inkurajon	1	50.0%	1	50.0%	2	.00	1.00
Për përfitime financiare	1	100.0%	0	0.0%	1	1.00	.31

Tabela 4 tregon se përse nxënësit marrin pjesë në veprimtari të ndryshme fizike. Në këtë pyetje, nxënësit kanë pasur të drejtë që të përgjigjen në tri alternativa se përse marrin pjesë në veprimtari të ndryshme fizike.

Në bazë të tabelës, rezultatet tregojnë se 34 nxënës nga zonat urbane janë përgjigjur se marrin pjesë në veprimtari të ndryshme fizike për karrier sportive, ndërsa 14 nxënës nga zonat rurale janë përgjigjur se marrin pjesë në veprimtari të ndryshme fizike për karrier sportive, sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës 6-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifikancës, është më e vogël se vlera $p - 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zonat urbane dhe rurale. 6 nxënës nga zonat urbane janë përgjigjur se marrin pjesë në veprimtari të ndryshme fizike të takojnë njerëz të rinjë, ndërsa 11 nxënës nga zonat rurale janë përgjigjur se marrin pjesë në veprimtari të ndryshme fizike të takojnë njerëz të rinjë, sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës 6-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifikancës, është më e madhe se vlera $p - 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zonat urbane dhe rurale. 29 nxënës nga zonat urbane janë përgjigjur se marrin pjesë në veprimtari të ndryshme fizike sepse ju pëlqejnë garat, ndërsa 35 nxënës nga zonat rurale janë përgjigjur se marrin pjesë në veprimtari të ndryshme fizike sepse ju pëlqejnë garat, sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës 6-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifikancës, është më e madhe se vlera $p - 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zonat urbane dhe rurale. 34 nxënës nga zonat urbane janë përgjigjur se marrin pjesë në veprimtari të ndryshme fizike për gjendje më të mire fizike, ndërsa po ashtu 34 nxënës nga zonat rurale janë përgjigjur se marrin pjesë në veprimtari të ndryshme fizike për gjendje më të mirë fizike, sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës 6-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifikancës, është më e madhe se vlera $p - 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zonat urbane dhe rurale. 46 nxënës nga zonat urbane janë përgjigjur se marrin pjesë në veprimtari të ndryshme fizike për relaksim, ndërsa 47 nxënës nga zonat rurale janë përgjigjur se marrin pjesë në veprimtari të ndryshme fizike

për relaksim, sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës 6-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të sigifikancës, është më e madhe se vlera $p - 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zonat urbane dhe rurale. 67 nxënës nga zonat urbane janë përgjigjur se marrin pjesë në veprimtari të ndryshme fizike për shëndet, ndërsa 63 nxënës nga zonat rurale janë përgjigjur se marrin pjesë në veprimtari të ndryshme fizike për shëndet, sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës 6-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të sigifikancës, është më e madhe se vlera $p - 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zonat urbane dhe rurale. 8 nxënës nga zonat urbane janë përgjigjur se marrin pjesë në veprimtari të ndryshme fizike të duken bukur, ndërsa 12 nxënës nga zonat rurale janë përgjigjur se marrin pjesë në veprimtari të ndryshme fizike të duken bukur, sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës 6-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të sigifikancës, është më e madhe se vlera $p - 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zonat urbane dhe rurale. 6 nxënës nga zonat urbane janë përgjigjur se marrin pjesë në veprimtari të ndryshme fizike për nota më të mira në lëndën e Edukatës Fizike në shkollë, ndërsa 14 nxënës nga zonat rurale janë përgjigjur se marrin pjesë në veprimtari të ndryshme fizike për nota më të mira në lëndën e Edukatës Fizike në shkollë, sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës 6-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të sigifikancës, është më e vogël se vlera $p - 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zonat urbane dhe rurale. 8 nxënës nga zonat urbane janë përgjigjur se marrin pjesë në veprimtari të ndryshme fizike për të takuar miq të rinjë, ndërsa 13 nxënës nga zonat rurale janë përgjigjur se marrin pjesë në veprimtari të ndryshme fizike për të takuar miq të rinjë, sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës 6-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të sigifikancës, është më e madhe se vlera $p - 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zonat urbane dhe rurale. 48 nxënës nga zonat urbane janë përgjigjur se marrin pjesë në veprimtari të ndryshme fizike për argëtim, ndërsa po ashtu 48 nxënës nga

